

Data: 28 Mars 2019

Banka Amerikane e Investimeve ShA njofton gjithë klientët e saj që kanë pasur llogari pranë ish-Bankës NBG Albania ShA se është në hapat e fundit të përmbylljes së bashkimit operacional të sistemit të saj operativ, me atë të përdorur nga ish – Banka NBG Albania ShA.

Si pasojë e këtij bashkimi, të dhënat e identifikimit të llogarive bankare të mbajtura pranë Bankës si psh. numri IBAN i llogarisë dhe të dhënat e Swift-it për kryerjen e transfertave brenda apo jashtë Shqipërisë, do të ndryshojnë.

Të gjithë klientët janë të mirëpritur në çdo degë të Bankës Amerikane të Investimeve ShA, për të tërhequr të dhënat e reja të identifikimit të llogarive bankare të mbajtur pranë Bankës dhe për të marrë informacion të mëtejshëm në lidhje me datën në të cilën këto ndryshime do të bëhen efektive. Në çdo rast, ndryshimet hyjnë në fuqi jo më parë se 30 ditë nga data e këtij njoftimi.

Ju falenderojmë edhe njëherë për marrëdhënien tuaj me Bankën, dhe urojmë të vazhdojmë të ecim përpara çdo ditë e më shumë, për të bërë sa më shumë biznes së bashku.

Me respekt,

Banka Amerikane e Investimeve ShA